



Në bazë të nenit 35 dhe paragrafi 10 të nenit 51 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik („Gz. zyrtare e RM-së,, nr.199/14, 44/15), nenit 50, pika 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gz. zyrtare e RM-së,, nr.5199/2014, 44/2015, 157/2015, 193/2015, 31/2016, 90/2017, 64/2018, 168/2018), nenit 22 të Statutit të Komunës së Likovës dhe miratimit të Programit vjetor për punimin e planeve urbanistike të Komunës së Likovës për vitin 2020 me Vendim nr. 08-1307/19 dt 30.12.2019 nga Këshilli i Komunës së Likovës, Kryetari i Komunës së Likovës e jep këtë:

L A J M Ě R I M

Për organizimin e prezentimit publik dhe anketës publike për Propozimine Kryetarit të Komunës së Likovës

Kufijtë e përfshirjes planore janë: **Projektin Arkitektoniko urbanistik me destinim D3-sport dhe rekreacion dhe D4-hapsira memorijale në nj pjesë të p.k. 31/1 v.q. Selishte, KK Sllupčan jashte rejonit, Komuna e Likovës.**

Përfshirja është sipërfaqe prej 5,67 ha.

Anketa publike dhe prezentimi publik me propozim programin e Kryetarit të Komunës, do të zbatohet me ekspozimin e Propozim Planit në hapësirat e sallës të Këshillit të Komunës së Likovës.

Anketa Publike do të zgjatë 5 ditë pune edhe ate prej 19-25.06.2020, çdo ditë pune nga ora 10,00 deri 14,00.

Në afatin e përmendur, qytetarët e interesur dhe personat juridik nga rajoni konkret të përfshirë me planin mund të dorëzojnë vërtetje me shkrim, propozime dhe mendime në listat anketuese.

Prezentimi publik me prezentimin profesional të planit do të mbahet më dt.23.06.2020 në ora 10,30 në hapësirat e sallës së Këshillit të Komunës së Likovës.

Punoi, Ida Dije Arifi
Kontrolloji, Xhezmi Musliji
Aprovoi, Nexhadi Osmani

Komuna e Likovës
Kryetar,
m-r Erkan Arifi

